



Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim
&
Zyra për Informim Publik dhe Marrëdhënie me Publikun

RAPORT NARRATIV

Aktiviteti: Diskutimi Publik i Buxhetit në vitin 2021

Në bazë të Ligjit për Financa publike dhe përgjegjësi, Kuvendi Komunal i Vitisë dhe drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim në bashkëpunim me Zyrën për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, me qëllim të planifikimit të buxhetit komunal për periudhën 2022-2024, gjatë muajit gusht 2021, ka mbajtur diskutimet publike me qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-24, me theks të veçantë projeksionin buxhetor për vitin 2022.

Diskusimet publike për buxhet të vitit 2022, janë mbajtur sipas këtij orari:

Data e diskutimit publik	Lokaliteti / Vendbanimi	Numri i pjesëmarrësve			Komentet
		M	F	Total	
20.08.2022	Gjinia femërore	1	37	38	Përfundimet: <ul style="list-style-type: none">• Të shtohet numri i përfituesve të bursave pa dallime në cilat drejtime.• Të parashtrahet një kërkesë në nivelin qendror që të ketë një kod të veçantë buxhetor për mbështetjen e viktimave të dhunës në familje.• Të zgjerohet kapacitet e çerdhes në qytetin e Vitisë ose të ndërtohet një çerdhe e re.• Të shtohet numri i psikologëve në shkollë.• Të ndërtohet një fabrikë ku

					punësohen vetëm gratë dhe të tjerë.
24.08.2022	Viti	11	1	12	<p>Përfundimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Asfaltimi dhe ndriçimi i rrugës "Ylvi Demiri". • Asfaltimi i rrugës "14 Qershori" në gjatësi prej 50 metrash. • Subvencionim të studentëve, konkretisht bursa për drejtime të ndryshme, • Një parking për taksistët në qendër të qytetit.
24.08.2022	Kabash	19	2	21	<p>Përfundimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rehabilitimin e rrjetit të ujësjes, ku do të furnizoheshin banorët me ujë të mjaftueshëm të pijes dhe që ky rrjet të hyjnë në sistemin e menaxhimit nga ana e Kompanisë rajonale të ujërave "Hidromorava". • Asfaltimin e rrugës kryesore Kabash-Viti • Rregullimin e hapësirave gjelbëruese. • Rrethojën e varrezave të fshatit. • Rregullimin e katër rrugëve bujqësore
25.08.2022	Sadovinë e Jerlive	10	0	10	<p>Përfundimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Funkcionalizimi i disa pjesëve të kanalizimit në disa lagje. • Veshja e shtratit të lumit me gurë. • Rregullimi i fushës sportive në oborrin e shkollës fillore. • Ndërtimi i një ure të "Guqutë", funksionalizimi i ujësjes dhe zgjatja e gypit kryesor për edhe 2 kilometra.

26.08.2022	Pozheran	17	2	19	<p>Përfundimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të ndërtohen trotuare në lagjet "Zuka" dhe "Alidema". • Të bëhet shtrimi i një rruge me zhavorr në drejtim të fshatit Gërmovë. • Të bëhet funksionalizimi i ujësjellësit të vjetër të Tërpezës. • Të rregullohet kanalizimi tek Jahi Ramiqi. • Të bëhet pastrimi dhe hapja e përroskës që kalon përmes këtij fshati. • Të ndërtohet një shtëpi e kulturës dhe të këtë më shumë shtigje për çiklizëm.
27.08.2022	Sportistët	19	6	25	<p>Përfundimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përkrahet financiarisht qendra Rinore. • Të rritet buxheti në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. • Të ngritet vetëdija e të rinjëve për pjesëmarrje në Hiking. • Të krijohen më shumë shtigje për çiklizëm, konkretisht përgjatë fshatrave Tërpezë, Pozheran, Viti dhe Binçë. • Të përkrahen edhe klube të ndryshme sportive për të rritur dhe fëmijë, nga të dyja gjinitë.

20.08.2012	Komuniteti shumicë	jo	3	1	4	Përfundimet: <ul style="list-style-type: none"> Furnizim të mjaftushëm me ujë të pijshëm Angazhimin e dy punëtorëve me kontratë, që do të merreshin kryesisht me pastrimin e ambientit publik.
23.08.2022	Arsimi		13	3	16	Përfundimet: <ul style="list-style-type: none"> Të vazhdohet me përkushtimin për investime si deri më tani në fushën e arsimit, për të zhvilluar një arsim cilësor, që të rezultojë me ngritjen profesionale të nxënësve.

23.08.2022	Shëndetësia		15	4	19	Përfundimet: <ul style="list-style-type: none"> Rregullimit të një ashensori në QKMF në Viti për mundësinë e ofrimit të shërbimit sa më të mirë sidomos për të moshuarit. U kërkua që të shqyrtohet mundësia për rritjen e buxhetit për shërbime e mallra.
Totali i pjesëmarrësve			108	56	164	
Përqindja:			66 %	34 %	100 %	

Publikimi në media:

Diskutimet për buxhet janë përcjellë nga Zyra për Informim Publik e Komunës së Vitisë dhe gjitha këto aktivitete janë publikuar në faqen zyrtare të internetit : www.kk.rks-gov.net/viti dhe në facebook Komuna e Vitisë.

Gjithashtu këto informacione janë prezantuar edhe në portalet:

Viti, 2022

Agron Abazi



ZIP-Viti

Mustafë Mehmeti

